



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VE N D I M

Nr. 543, datë 9.7.2020

PËR

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR
NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR BLERJEN E APARTAMENTEVE,
QË DO T'IU DHUROHEN FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE SI PASOJË
E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019, NGA BASHKIA KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 18, pika 2, dhe 24, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të aktit normativ nr.6, datë 30.11.2019, të Këshillit Ministrave, "Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VE N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 18 263 702 (tetëmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dy) lekë, për blerjen e 5 (pesë) apartamenteve, që do t'iu dhurohen familjeve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, nga Bashkia Kamzë.
2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi i rindërtimit, pjesa e financuar nga buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I SHETITIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

U

NR.PROT. 3516/1
DATË 10.7 . 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË SË KAMZËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

